



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 497/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Ymer Hoxha dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV) dega në Malishevë, paraqitur kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Malishevë, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet Lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 06.11.2013, mori këtë:

### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), dega në Malishevë .

### Arsyetim

Me datën 04.11.2013, LVV-ja, ka parashtruar ankesë në PZAP, në të cilën pretendohet se, me datë 03.11.2013 rreth orës 11:45 në Bellanicë, në afërsi të shkollës së mesme “Ismail Qemali” Qendra e Votimit 3028 nga militantët e LDK-së janë vendosur poster te kandidatit për kryetar të komunës nga radhët e LDK-së.

Parashtruesi i ankesës ka theksuar se një veprim i tillë është në kundërshtim me dispozitat e nenit 33 pika b e LZP-së, dhe nenit 4.1 pika b e Rregullave Zgjedhore nr.11/2013. Parashtruesi i ankesës si provë ka ofruar dy fotografi si dëshmi .

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

### ankesa është e pabazua

PZAP-i, konstatoi nga shkresat e lëndës se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë ngase nuk janë ofruar dyshimi të asaj natyre që të nikonin për të marr ndonjë vendim ndryshe andaj një pretendim i tillë është i përgjithshëm dhe i pa qartë për tu administruar si provë relevante, duke u bazuar në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 497/2013 më datën 06.11.2013.

Kryesuesi i Panelit  
Xhevdet Abazi



### **Këshillë Juridike:**

PZAP-i nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*